



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT BERAT

Nr. 572 Prot
10

Datë 30 / 06 / 2025

VENDIM

Nr. 7, Datë 27 / 06 / 2025

PËR
MIRATIMIN E PROPOZIMIT PËR MBËSHTETJEN FINANCIARE PËR ZBATIMIN E
PROJEKTIT TË KUJDESIT SHOQËROR PËR VITIN 2026

Mbështetur në Ligjin nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar), në Ligjin nr.121/2016, datë 24.11.2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.224, datë 09.04.2024 "Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror", Këshilli i Qarkut:

V E N D O S I:

I. Të miratojë propozimin për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për mbështetjen financiare për zbatimin e projektit të kujdesit shoqëror si më poshtë:

1- Projekti për Qendrën Sociale për të Moshuarit "Shtëpia e përbashkët", për periudhën 01 janar -31 dhjetor 2026 me fond total 15,067,417 lekë nga të cilat:

1.1 Mbështetja financiare për zbatimin e projektit është në vlerën 9,430,313 lekë për mbulimin e shpenzimeve për paga dhe sigurime për 9 punonjës të drejtëpërdrejtë (7 me kohë të plotë dhe dy me kohë të pjesëshme)

1.2 Mbështetja financiare për trajtimin ushqimor për 80 të moshuar është 5,637,104 lekë.

II. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Sekretari i Këshillit, Administrata e Këshillit të Qarkut Berat dhe Qendra Sociale për të Moshuarit.

III. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 3 të nenit 78 të Ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar).



Këshilltarë gjithsej	<u>18</u>
Morën pjesë	<u>12</u>
Votuan Pro	<u>12</u>
Votuan Kundër	<u>-</u>
Abstenim	<u>-</u>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT
BERAT

RELACION
MBI PROJEKT-VENDIMIN
“PËR MIRATIMIN E PROPOZIMIT PËR MBËSHTETJEN FINANCIARE PËR
ZBATIMIN E PROJEKTIT TË KUJDESIT SHOQËROR PËR VITIN 2026”

Këshilli i Qarkut Berat, në bashkëpunim dhe me mbështetje të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ka miratuar me anë të Vendimit Nr. 08, datë 29.03.2016 (verifikim i akteve të ligjshmërisë nga ana e Prefektit të Qarkut me shkresën nr. 419/1, datë 05.04.2016) funksionimin dhe aktivitetin e Qendrës sociale për të moshuarit “Shtëpia e Përbashkët”.

Me qëllim vijueshmërinë e këtij projekti në përputhje me “Udhëzuesin për paraqitjen e kërkesave për njësitë e qeverisjes vendore” nevojitet aprovimi i përvitshëm në Këshillin e Qarkut.

Qendra Sociale “Shtëpia e Përbashkët” Berat, është një institucion i përkujdesit social për të moshuarit, i cili ofron shërbime për 60 (gjashtëdhjetë) të moshuar duke synuar respektimin e të drejtave, përmirësimin e cilësisë së jetës dhe integrimin e tyre në shoqëri me qëllim shmangien e përjashtimit social. Gjatë veprimtarisë së kësaj qendre me eksperiencë 8 vjeçare janë depozituar kërkesa të vazhdueshme nga të moshuar që kanë vështirësi ekonomike, që janë të vetëm dhe që kanë shumë nevojë për shërbimet që ofrohen në këtë qendër sociale. Për këtë arsye do të kërkohet fond për trajtim ushqimor për 80 përfitues.

Këshilli i Qarkut Berat së bashku me stafin e Qendrës Sociale për të Moshuarit dëshiron që shërbimi ynë kundrejt këtij targetgrupi të ofrohet për sa më shumë persona në mënyrë që t'u qëndrojmë sa më pranë komunitetit e të mundësojmë që këtë periudhë të jetës ta kalojnë sa më mirë dhe të jenë të përfshirë me pjesën tjetër të të moshuarve për të cilët ne kemi vite që tregojmë kujdes e që i mbështesim me përkushtim.

Bazuar në organikën e miratuar, Qendra Sociale “Shtëpia e Përbashkët” operon me një staf prej 9 punonjësish të drejtpërdrejtë (7 punonjës me kohë të plotë dhe dy me kohë të pjesëshme) për të cilët nevojitet fondi prej 8,092,282 lekë për paga dhe 1,338,031 lekë për sigurime dhe në total 9,430,313 lekë.

Shpenzimet për ushqim për 80 të moshuar të përlogaritura sipas udhëzimit përkatës janë në vlerën 5,637,104 lekë.

Në total për paga sigurime dhe ushqim për vitin 2026 për 9 punonjës të drejtpërdrejtë dhe 80 të moshuar nevojiten 15,067,417 lekë.